



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:171747

Datë: 09.07.2024

Numri i dokumentit: 05914857

**K.DH.SH.II.nr.812/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Rexha SHPK me NUI 703284474 me seli në Prishtinë, ndaj debitorit Komuna e Prishtinës, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se pare-Departamenti Ekonomik, KPPP.nr.1262/23 të datës 27.09.2024, me datën 08.07.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

APROVOHET si e bazuar ankesa e debitorit Komuna e Prishtinës, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se pare-Departamenti Ekonomik, KPPP.nr.1262/23 të datës 27.09.2024, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, i ushtruar kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.216/2023 dt.27.07.2023 dhe ANULOHET Urdhri përmbarimor P.nr.216/2023 dt.27.07.2023 i Përmbaruesit Privat Mubarak S. Shumolli. PËRFUNDOHET përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

### **A r s y e t i m**

Gjykatës Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se pare-Departamenti Ekonomik, KPPP.nr.1262/23 të datës 27.09.2024, ka refuzuar ne tërësi si te pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, te ushtruar kundër urdhrin përmbarimor P.nr.216/2023 dt.27.07.2023, i lejuar na zyra e përmbaruesit privat Mubarak S. Shumolli me adrese rr. Ahmet Krasniqi në Ferizaj dhe ka lënë ne fuqi Urdhrin Përmbarimor P.nr.216/2023 dt.27.07.2023.

Kundër këtij aktvendimi ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljeve te dispozitave te procedurës kontetimore dhe përmbarimore, konstatim te gabuar dhe jo te plot të gjendjes faktike dhe zbatim te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkallës se dytë te aprovoj

ankesën e debitorit Komuna e Prishtinës anuloi aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkalles së parë-Departamenti Ekonomik, KPPP.nr.1262/23 të datës 27.09.2024 dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

**-Ankesa e debitorit është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të titullit ekzekutiv – aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike II.EK nr. 202/19 dt. 08.02.2021, dhe aktgjykimin të gjykatës Komerciale Dhomat e Shkalles së dytë K.DH.SH.II nr. 861/22 dt.06.07.2023. përmbartuesi privat ka nxjerr Urdhrin Përmbartimor P.nr.216/2023 dt.27.07.2023 me të cilin e ka urdhëruar Debitorin që në emër të kompensimit të demit si dhe fitimit e humbur të përcaktuar në baze të aktgjykimin e lartecukur si dokument përmbartimor paguaj shumën prej 813,039.50€ me kamat ligjore prej 8% prej dt.21.07.2021 sipas aktgjykimin nga dita e paraqitjes e padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzime të procedurës në shumë prej 487euro.

Kundër urdhrin përmbartimor debitorin ka paraqitur prapësim, duke theksuar se e kundërshton urdhrin përmbartimor me të cilin është lejuar përmbartimi. Ndaj prapësimin të debitorin, kreditori ka parashtruar përgjigje, me arsyetimi se nuk qëndrojnë arsyet e dhëna nga debitorin në prapësim, andaj propozon që prapësimi i debitorin të refuzohet.

Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkalles së parë-Departamenti Ekonomik, KPPP.nr.1262/23 të datës 27.09.2024, ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorin Komuna e Prishtinës, të ushtruar kundër urdhrin përmbartimor P.nr.216/2023 dt.27.07.2023, i lejuar në zyra të përmbartuesit privat Mubarak S. Shumolli me adresë rr. Ahmet Krasniqi në Ferizaj dhe ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbartimor P.nr.216/2023 dt.27.07.2023, me gjerësisht si në arsyet e vendimit të atakuar.

Dhoma e shkalles së dytë e Gjykatës Komerciale si gjykatë e shkallës së dytë, sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, e vlerëson aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë, brenda kufijve të shkaqeve ankimore të theksuara në ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 nën pikën b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji dhe aplikimin e drejtë të së drejtës material, si dhe nenit 66 LPP-së.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhoma e shkalles së dytë vlerëson se nuk mund ta pranojë përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë

pasi gjendja faktike qëndron ndryshe nga ajo e vlerësuar nga Gjykata e shkallës së parë ashtu që edhe e drejta materiale ndryshe duhet zbatuar, prandaj Gjykata e shkallës së dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë rast marrë parasysh shkresat në lëndë dhe aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës nr. E.REV.nr. 26/2023 dt.21.11.2023 me të cilin aktvendim është vendosur 'Aprovohet si i bazuar revizioni i të paditurës Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, prishen aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, K.DH.SH.II.861/2022, i datës 06.07.2023, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Ekonomike IV.EK.C.nr.202/2019, datë 08.02.2021, dhe çështja i kthehet Gjykatës Komerciale në shkallë të parë, për rigjykim. Nga ky aktvendimi i Gjykatës Supreme Titulli përmbartimor mbi baze të cilin është lejuar Urdhër Përmbartimor është Prishë dhe lënda është kthyer në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, andaj në vështrim të dispozitave ligjore të nenit 66 të LPP-së, 'Përfundimi i procedurës përmbartimore 1. Në qoftë se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe, përmbartimi do të përfundojë sipas detyrës zyrtare në qoftë se dokumenti përmbartimor është anuluar, ndryshuar, shfuqizuar, apo në ndonjë mënyrë tjetër është bërë i pa efekt, apo në qoftë se vërtetimi për përmbartueshmërinë e tij anulohet me vendim të formës së prerë'. Andaj në baze të dispozitave të lartcekura dhe aktvendimit të Gjykatës Supreme Gjykatës Supreme të Kosovës nr. E.REV.nr. 26/2023 me të cilin është prishë titulli përmbartimor rezulton se duhet përfundoj procedura përmbartimore në këtë çështje përmbartimore, për arsye se, është anuluar Titulli përmbartues-Titulli ekzekutiv, mbi baze të cilin është lëshuar Urdhri përmbartimor P.nr.216/2023 dt.27.07.2023 dhe si i tillë është pa efekt juridik.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjënë se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe urdhri për lejimin e përmbartimit nga ana e Përmbartuesit Privat të shfuqizohet.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.812/24, me datë 08.07.2024

Gjyqtari,  
Ramush Bardiqi